



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:138014  
Datë: 20.02.2024  
Numri i dokumentit: 05347856

AC.nr.4892/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin gjyqësor, në përbërje prej gjyqtarit Besnik Bislimaj kryetar i kolegjit dhe gjyqtarët Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit R. I. nga fshati Bllacë, Komuna e Suharekës, të cilin e përfaqëson me autorizim av. N. H. nga Suhareka, kundër të paditurit L. R. M. nga fshati R, Komuna e Suharekës, për shkak të borxhit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në S, C.nr.294/2016, i datës 06.05.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 16.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e të paditurit L. R. M. nga fshati Reshtan, Komuna e Suharekës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Dega ne Suharek, C.nr.294/2016, i datës 06.05.2021, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.294/2016, i datës 06.05.2021, e ka aprovuar: APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia paditësit: R. I. nga fshati Bllacë, Komuna e Suharekës, të cilin me autorizim e përfaqëson av. N. H. nga Suhareka, ashtu që: I. DETYROHET i padituri L. R. M. nga fshati Reshtan, Komuna e Suharekës, që paditësit t'ia paguaj, shumën prej 10.500 euro (dhjet mijë e pesëqind euro për shkak të mos përmbushjes së borxhit/ huas sipas kontratës së dt.30.01.2016, e hartuar në zyrën e av. N. B. nga Suhareka, ku obligohet i padituri që paditësit t'ia paguaj edhe kamatën ligjore prej 8% duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 07.09.2016 deri në pagesën përfundimtare në afat prej 15 ditësh nga

plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. II. Detyrohet i padituri që ti bart edhe shpenzimet e krijuara në procedurën gjyqësore në shumën prej 1,289.00 euro (njëmijë e dyqind e tetëdhjetë e nëntë euro), të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë i paditurit, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave procedurale kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo te plote të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet ashtu që të refuzohet si e pa bazuar kërkesë padia e paditësit, apo i njëjti të priset dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Përgjigje ne ankese, ka paraqitur paditësi me te cilën i ka propozuar Gjykatës se Apelit ne Prishtinë, te refuzoj ankesën e te paditurit si të pa bazuar ashtu që aktgjykimin e shkalles se pare te vërtetoj.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar .

Nga shkresat e lëndës, rrjedh se paditësi R. I. nga fshati Bllacë, Komuna e Suharekës, me datë 07.09.2016, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi, kundër të paditurit L. R. M. nga fshati Reshtan, Komuna Suharekë, për shkak të borxhit, me kërkesë si në kërkesë padinë e parashtruar me shkrim.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas dëgjimit të palëve ndërgjyqëse, administrimit të provave ka marrë aktgjykimin e ankimuar C.nr. 294/2016 të datës 06.05.2021, me të cilin e ka aprovuar në tërësi kërkesë padinë e paditësit, duke vendosur konkretisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, ka theksuar se: Pas administrimit të provave, gjykata ka vërtetuar se këtu paditësi ia ka dhënë hua të paditurit shumën prej 14.500 euro, pas nënshkrimit të kontratës me datë 30.01.2016. Këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga këto prova Kontratën mbi huadhënien e të hollave e lidhur me dt.30.01.2016, e hartuar pranë zyrës së av. N. B., nga dëgjimi i dëshmitarit H. K. dhe L. B.. Pra, sipas objektit të Kontratës mbi huadhënien e lidhur me dt.30.01.2016, është përcaktuar se shuma prej 14.500euro, do të jepen në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate. Po ashtu këtë fakt gjykata e ka vërtetuar edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve H. K. i cili ka theksuar se shuma prej 14.500 euro iu ka dhënë të paditurit ditën e nënshkrimit të kontratës. Po ashtu edhe dëshmitari tjetër i cili e ka hartuar kontratën e huas, L. B., ka theksuar se këtu palët ndërgjyqëse së bashku me H. kanë ardhur në zyre të cilët kanë kërkuar nga unë që të hartojë kontratën e huas, ku ka theksuar se, “kontrata është lidhur pa presion, kjo bazuar në faktin se të njëjtit ishin në harmoni në mes vete”.

Më tej ka theksuar se: Gjykata i ka shqyrtuar me kujdes edhe pretendimet e të paditurit i cili ka theksuar se i njëjti nga paditësi i ka marrë hua shumën prej 3000euro e 450 franga, por këto

pretendime të të paditurit gjykata nuk ka mundur që ti vërtetoj me asnjë provë, pasi që i padituri nuk ka propozuar asnjë provë për vërtetimin e këtij pretendimi.

Më tej ka theksuar se: Shumën e borxhit prej 10.500 euro gjykata e vërtetoi nga dëgjimi i palëve, ku paditësi i dëgjuar në cilësi të palës në seancën e datës 15.01.2020 ka pranuar se shuma prej 4000 euro i është dhënë nga i padituri, po ashtu këtë fakt gjykata e ka vërtetuar edhe nga deklarimi të paditurit, i cili ka theksuar në fjalën përfundimtare të datës 24.03.2021 se paditësit ia ka dhënë 4000euro përmes mikut të tij B. Z..

Më tej ka theksuar se: Sa i përket të drejtës materiale gjykata bazohet në Ligjin Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr.04/L-077, ju në nenin 15 të saj është paraparë që, citojmë: *“Kontrata është e lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të kontratës”*. Pra, siç shihet nga objekti i kontratës mbi huadhënien e lidhur me dt.30.01.2016, e hartuar pranë zyrës së av. N. B., është specifikuar se, citojmë: *“objekt i kësaj kontrate është dhënia respektivisht marrja me hua pa kamatë e shumës prej 14.500euro, të cilat të holla do të ipen në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate”*. Ndërsa me nenin 567 parag.1 të LMD-s është paraparë që, citojmë: *“Me kontratën e huas huadhënësi obligohet t'ia dorëzojë huamarrësit një shumë të caktuar të hollash ose sasinë e caktuar të sendeve të tjera të zëvendësueshme, ndërsa huamarrësi obligohet ta kthejë pas një kohe të caktuar të njëjtën shumë të hollash, përkatësisht të njëjtën sasi sendesh të llojit dhe të cilësisë së njëjtë”*. Ndërsa çështjen e dorëzimit të mjeteve në shumën prej 14.500euro gjykata e ka vërtetuar nga dëgjimi i dëshmitarit H. K., i cili ka theksuar se pas nënshkrimit të kontratës paditësi ia ka dhënë këtë shumë të paditurit, po ashtu gjykata e ka vërtetuar faktin se këtu i padituri ia ka kthyer paditësit shumën prej 4000 euro, por jo edhe pjesën tjetër prej 10.500euro.

Më tej ka theksuar se: Sa i përket pretendimeve të cilat ka theksuar i padituri se këtu i njëjti e ka nënshkruar kontratën e huas i gjendur para presionit të palës paditëse, por në pyetjen e parashtruar nga ana e gjykatës në seancën e datës 15.01.2020 se për këtë presion këtu i padituri a i ka lajmëruar organet kompetente i njëjti ka theksuar se jo ai personalisht por komshiu e tij. Ndërsa në pyetjen tjetër të gjykatës se a ka të hapur procedurë penale për këtë rast i njëjti ka theksuar s epo lënda gjendet në prokurori. Kurse nga Aktvendimin për fillimin e hetimeve nga Prokuroria Themelore Prizren, me nr.PP.nr.946-7/16 e datës 27.04.2016 dhe Aktvendimi për pushimin e hetimeve nga prokuroria Themelore Prizren, me nr.PP.nr.946-72016-II e datës 23.04.2018, gjykata ka vërtetuar faktin se prokuroria i ka pushuar hetimet ndaj paditësit.

Vendimi mbi kamatën e gjykuar është marrë në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në kuptim të nenit 452 par. 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditësit se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i kjartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar e që aktgjykimin e ankimuar e bënë në harmoni të plotë me nenin 160 të LPK-së.

I padituri nuk ka ofruar kurrfarë prove për të konstatuar faktin se ai e ka përmbushur detyrimin e tij në raport me paditësin, përveç faktit që i njëjti ka paguar shumën prej 4,000.00 euro, të cilin fakt e ka pohuar edhe paditësi dhe nuk ka qenë kontestues e mbi të gjitha kjo shumë nuk ka qenë edhe objekt kontesti në këtë çështje kontestimore, ndërsa për shumën prej 10,500.00 euro i padituri nuk ka ofruar prova për të argumentuar se ka përmbushur pjesërisht apo tërësisht detyrimin kontraktues të huas.

Gjykata e Apelit i vlerëson të pa qëndrueshme pretendimet ankimore të paditurit në lidhje me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata e shkallës së parë nga provat e administruara drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka konstatuar gjendjen faktike, pasi që edhe gjykatës së Apelit i rezulton e njëjta gjendje faktike e vërtetuara, pasi që nga provat e administruara në shqyrtim kryesor por edhe nga vetë pohimi i të paditurit është konstatuar fakti se i padituri me 30.01.2016 kishte marr hua të holla prej paditësit, në shumën prej 14,500.00 euro, për këtë palët ndërgjyqësore kishin lidhur kontratë mbi huan e të hollave, kontratë kjo e datës 30.01.2016, fakt ky jo kontestues në mesë palëve ndërgjyqës, gjykata provoj faktin se në mesë palëve ndërgjyqësve ka ekzistuar marrëdhënia kontraktuese e huas, ku paditësi në cilësinë e huadhënësit ia kishte huazuar shumën prej 14,500.00 euro të paditurit në cilësinë e huamarrësit, e që është vërtetuar edhe nga dëgjimi i dëshmitarëve se i padituri këto mjete i ka pranuar nga paditësi e që kishte për obligim që mjetet e marra hua ti kthe me afatin për kthim të përcaktuar si në këtë kontratë dhe atë shumën prej 4,000.00 euro të kthehet më 20.02.2016, ndërsa shumën prej 10,500.00 euro të kthehet me datën 30.06.2016 pa kamatë, ashtu siç ishte rregulluar në nenin 1 të kontratës të cilët dhe kanë paraparë edhe afatin e fundit të kthimit të mjeteve të marra hua nga i padituri më së largu deri me datën 30.06.2016. Po ashtu nga dëgjimi i paditësit dhe të paditurit në cilësi të palës është vërtetuar se i padituri ka paguar shumën prej 4,000.00 euro.

Gjykata e Apelit, vlerëson se mbi bazë të gjendjes faktike të konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe të drejtën materiale. Me nenin 245 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) parashihet se ” Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij” me nenin 567 të po këtij ligji është paraparë se “Me kontratën e huas huadhënësi obligohet t’ia dorëzojë huamarrësit një shumë të caktuar të hollash ose sasinë e caktuar të sendeve të tjera të zëvendësueshme, ndërsa huamarrësi obligohet ta kthejë pas një kohe të caktuar të njëjtën shumë të hollash, përkatësisht të njëjtën sasi sendesh të llojit dhe të cilësisë së njëjtë”. Me nenin

568 paragrafi 1 LMD është paraparë se “Huamarrësi mund të obligohet që përveç kryegjësë të debitorëve edhe kamatën”.

Gjykata e Apelit i vlerësoj pretendimet e të paditurit në lidhje me atë se i njëjti ka paguar shumën prej 4,500.00 euro përmes një të afërmit të tij, por të njëjtat pretendime ashtu siç nuk janë marrë për bazë nga gjykata e shkallës së parë, nuk do të merren as nga gjykata e Apelit, pasi që i padituri përpos deklarimeve të tij për një fakt të tillë, i njëjti nuk i ka mbështetur me asnjë provë përmes së cilave prova do të vërtetonte një fakt të tillë. Andaj sit ë tillë nuk janë marrë në vlerësim fare.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime në përputhshmëri të plotë me veprimet procedurale, e gjithashtu duke pas parasysh edhe suksesin e paditësit në procedurë dhe atë në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së dhe tarifës së OAK-së.

Gjykata e Apelit nga të cekurat më lartë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 194, 195 pika d) të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - PRISHTINË  
AC.nr.4892/2021, me date 16.02.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari  
Besnik Bislimaj, d.v